



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF
GJAKOVA



Zyra e Prokurimit
Komuna e Gjakovës

Në bazë të nenit 72 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, Neni 9 të Kushtetutit të Përgjithshme të Kontratës (KPK) në lidhje me kontratën me numër të prokurimit: 632-23-9550-2-2-5, numër të brendshëm 632-23-145-225 dhe me nr. të protokollit 01nr.410/04-19619, për shkak të mos-përbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e Kontraktorit: " SYRI " SH.P.K., rr."Sadik Pozhegu", Gjakovë, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësisë ligjore, më dt. 06.11.2024, Zyrtari përgjegjës i prokurimit, Ju njofton:

NJOFTIM
Për ndërprerjen e Kontratës

Neni 9, paragrafi 9.1 i KPK përcakton se "Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

Ju informojmë se kontrata e nënshkruar me datën 02.10.2023, me numër te prokurimit: 632-23-9550-2-2-5 ,numër të brendshëm 632-23-145-225 dhe me nr. te protokollit 01nr.410/04-19619, me titull 'Përcjellja mediatike e aktiviteteve Komunale'', ne mes të Komunës së Gjakovës dhe Punë kryesit " SYRI " SH.P.K., rr."Sadik Pozhegu", do te ndërpritet me date 12.11.2024.

Kontrata do te ndërpritet duke u bazuar ne nenin 9, paragrafi 9.1 nën: a dhe b, te Pjesa II e Kontratës – Kushtet e Përgjithshme si dhe kërkesës së dt.06.11.2024, të Menaxherit të kontratës për shkëputje të kontratës.

Deri me datë 21 10.2024 , shërbimet janë kryer në bazë të kontratës.

Më datë 21 Tetor 2024, ju keni dërguar njoftim në email-in zyrtar të Zyrës për Informim për ndërprerje të shërbimit "Transmetimi i drejtpërdrejtë i mbledhjes së Kuvendit të Komunës së Gjakovës".

Më datë 22 Tetor 2024, jeni takuar zyrtarisht me përfaqësuesit e komunës, ku jeni njoftuar për domosdoshmërinë e respektimit të plotë të kontratës.

Përmes e- emailit, jeni njoftuar se Komuna e Gjakovës nuk mund të anashkalojë detyrimet ligjore të kontraktuara ku përfshihet edhe transmetimi i mbledhjeve të Asamblesë Komunale duke përfshirë këtu edhe transmetimin e reprizave të kësaj mbledhje.

Poashtu më datë 22 Tetor 2024, ju keni dërguar email zyrtar, duke na njoftuar që kanë gjetur zgjidhje për transmetimin e mbledhjes në webfaqen zyrtare të Komunës së Gjakovës, por jo edhe në kanalin e juaj televiziv, me arsyetimin që do të mundoheni të bëni zgjidhje në ndërkohë.

Më dt. 29 Tetor, është ripërsëritur domosdoshmërinë që mediumi juaj të transmetojë mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Gjakovës në kanalin televiziv, dhe jeni njoftuar se nëse kontrata nuk zbatohet si e plotë, atëherë jemi të detyruar të iniciojmë procedurat për shkëputjen e saj.

Gjithashtu me datën 30 Tetor 2024, përmes emailit keni njoftuar se do ta përcjellni këtë ngjarje, por që ajo do të transmetohet vetëm në webfaqen zyrtare, por jo në

kanalin televiziv ashtu sic e parasheh kontrata me arsyetimin se nuk mund të ofroni këtë shërbim për shkaqe teknike.

Më datë 30 tetor 2024, ekipi i mediumit tuaj nuk ka përcjellë mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Gjakovës, ku përmes emailit, keni njoftuar që deri në rregullimin e problemeve teknike, mbledhja e Kuvendit të Komunës së Gjakovës do të transmetohet në webfaqen tonë zyrtare, por jo edhe në kanalin televiziv, për shkak të problemeve teknike por edhe financiare.

Përkundër vërejtjeve të shumta ju nuk ndërmorët veprime të nevojshme për përmirësim dhe realizimin shërbimeve siç ju ngarkon kontrata, prandaj në këto rrethana, menaxherja e kontratës, me dt 06.11.2024, përmes e-mailit ka kërkuar shkëputjen e kontratës me numër të prokurimit: 632-23-9550-2-2-5 dhe numër të brendshëm 632-23-145-225 dhe me nr. të protokollit 01nr.410/04-19619, me titull 'Përcjellja mediatike e aktiviteteve Komunale' e lidhur me dt.02.10.2023.

Si Autoritet Kontraktues që kemi zhvilluar aktivitetin e prokurimit dhe kemi nënshkruar kontratën, ju informojmë se menjëherë pas datës 12.11.2024, do të ndërmarrim të gjitha veprimet konformë kushteve të kontratës.

Shkresës i bashkëngjiten të gjitha komunikimet e deritanishme dhe dëshmitë e mos realizimit të kontratës.

Me respekt,

Udhëheqës i zyrës së Prokurimit





REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DATË/A:	06.11.2024
REFERENCË:	
PËR/ZA/TO:	Zyra e Prokurimit – Komuna e Gjakovës
CC:	z. Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
NGA/OD/FROM:	Donika Grezda – Menaxhere e kontratës
TEMA/SUBEKAT/SUBJECT	Kërkesë për ndërprerje të kontratës “Përcjellja mediatike e aktiviteteve komunale me numër identifikues 632-23-9550-2-2-5 dhe numër të brendshëm 632-23-145-225”

I nderuar zotëri Guta

E nderuar përfaqësuese e Zyrës së Prokurimit,

Po ju shkruaj lidhur me kontratën “Përcjellja mediatike e aktiviteteve komunale me numër identifikues 632-23-9550-2-2-5 dhe numër të brendshëm 632-23-145-225” të lidhur më datë 03.10.2023, në mes të Komunës së Gjakovës dhe SYRI SH.P.K Sadik Pozhegu Gjakovë.

Deri më datë 21 Tetor 2024, shërbimet janë kryer në bazë të kontratës.

Më datë 21 Tetor 2024, ky operator ka dërguar njoftim në email-in zyrtar të Zyrës për Informim për ndërprerje të shërbimit “Transmetimi i drejtpërdrejtë i mbledhjes së Kuvendit të Komunës së Gjakovës”.

Më datë 22 Tetor 2024, jemi takuar zyrtarisht me përfaqësues të këtij mediumi për t’i njoftuar rreth domosdoshmërisë për respektimin e plotë të kontratës. Më pas, i’u kemi dërguar edhe email me njoftimin se Komuna e Gjakovës nuk mund të anashkalojë detyrimet ligjore të kontraktuara me këtë operator, ku përfshihet edhe transmetimi i mbledhjeve të Asamblesë Komunale duke përfshirë këtu edhe transmetimin e reprizave të kësaj mbledhje.

Poashtu më datë 22 Tetor 2024, ky medium na ka dërguar email zyrtar, duke na njoftuar që kanë gjetur zgjidhje për transmetimin e mbledhjes në webfaqen zyrtare të Komunës së Gjakovës, por jo edhe në kanalin e tyre televiziv, me arsyetimin që do të mundohen të bëjnë zgjidhje në ndërkohë.

Më datw 29 Tetor, e kemi ripërsëritur domosdoshmërinë që ky medium të transmetojë mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Gjakovës në kanalin televiziv, sepse në momentin që pranohen shërbime të përgjysmuara nga mediumi në fjalë, nënkuptohet shkelje e kontratës nga ana jonë. Përmes këtij email-i i kemi njoftuar se nëse kontrata nuk zbatohet si e plotë, atëherë jemi të detyruar të inicojmë procedurat për shkëputjen e saj.

Pas njoftimit tonë për media për mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Gjakovës të paraparë për datën 30 Tetor 2024, kemi pranuar email nga mediumi se ata do ta përcjellin këtë ngjarje, por që ajo do të transmetohet vetëm në webfaqen zyrtare, por jo në kanalin televiziv ashtu sic e parasheh kontrata. Edhe kësaj here, arsyetimi ishte se ata nuk mund të ofrojnë këtë shërbim për shkaqe teknike.

Më datë 30 tetor 2024, ekipi i mediumit nuk ka përcjellë mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Gjakovës. Në të njëjtën ditë, ata kanë dërguar email, duke na njoftuar që deri në rregullimin e problemeve teknike, mbledhja e Kuvendit të Komunës së Gjakovës do të transmetohet në webfaqen tonë zyrtare, por jo edhe në kanalin televiziv, për shkak të problemeve teknike por edhe financiare.

Në këto rrethana, unë si menaxhere e kontratës "Përcjellja mediatike e aktiviteteve komunale me numër identifikues 632-23-9550-2-2-5 dhe numër të brendshëm 632-23-145-225" të lidhur më datë 03.10.2023, në mes të Komunës së Gjakovës dhe SYRI SH.P.K Sadik Pozhegu Gjakovë, për shkak të mosrespektimit të plotë të kontratës ashtu sic e kërkon ligji, kërkoj nga ju si autoritet që të vazhdoni procedurat për shkëputjen e saj.

Donika Grezda

From: Zyra Informimit
Sent: Tuesday, October 22, 2024 2:35 PM
To: Office Syri Vision
Cc: Nita Efendia; Faton Gutaj; Artan Haraqia; Donika Grezda
Subject: RE: Njoftim

Përsëritje të nderuar,

Kërkesat e Komunës së Gjakovës mbasin ashtu siç janë të përcaktuara në specifikat e kontratës që është valide deri me datë 01.10.2025.

Kjo për faktin se Komuna e Gjakovës nuk mund të anashkalojë detyrimet ligjore dhe të kontraktuara me ju, siç është Transmetimi i drejtpërdrejtë i plotë televiziv i mbledhjeve të Asamblesë Komunale, reprizën në orët e mbrëmjes dhe pikat tjera të specifikuara në kontratë.

Transmetimi i drejtpërdrejtë në ueb faqen zyrtare të komunës së Gjakovës është i domosdoshëm për ne, megjithatë kjo nuk mund ta tejkalojë faktin e rëndësishëm për transmetimin e drejtpërdrejtë televiziv ashtu siç parashihet në kontratë.

Sipas deklarimeve tuaja, transmetimin e drejtpërdrejtë të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës nuk mund të realizoni, andaj kërkojmë nga ju që të na njoftoni përfundimisht nëse një gjë e tillë do të realizohet apo jo.

Me respekt,

Donika Grezda
Menaxhere e Kontratës

From: Office Syri Vision <office@syri-vision.tv>
Sent: Tuesday, October 22, 2024 9:45 AM
To: Zyra Informimit <zip.gjakova@rks-gov.net>
Subject: Re: Njoftim

Caution! This message was sent from outside your organization.

[Allow sender](#) | [Block sender](#)

Përsëritje

Lidhur me njoftimin tonë paraprak për vështirësi financiare për të realizuar shërbimet ndaj institucionit tuaj:


Pas takimit të sotëm ku I përsëritëm shqetësimet tona lidhur me vështirësitë financiare më të cilat përballemi për të arritur ti përmbushim kërkesat për mbulim mediatik të aktiviteteve tuaja, kuptuam rëndësinë e transmetimit të drejtpërdrejtë të mbledhjes së Kuvendit të komunës së Gjakovës në Web faqen e institucionit tuaj. Pas konsultimeve me departamentin teknik arritëm të gjejmë një zgjidhje që të mund të vazhdojmë ta kryejmë këtë shërbim. Andaj, ju njoftojmë se mund të vazhdojmë ta transmetojmë mbledhjen e kuvendit në Web faqen e komunës së Gjakovës

On Mon, 21 Oct 2024 at 08:32, Office Syri Vision <office@syri-vision.tv> wrote:

Përshëndetje

Po ju drejtohemë përmes këtij emaili për të njoftuar për ndërprerje të përkohshme të njërit nga shërbimet që e kemi ofruar deri më tani, "Transmetimi I drejtpërdrejt I mbledhjes së Kuvendit të komunës së Gjakovës". Për shkak të kostos tejet të lartë që na ngarkohet për të ofruar këtë shërbim si për pajisje teknike ashtu edhe për angazhim të stafit realizues, aktualisht për ne është e papërballueshme të vazhdojmë të ofrojmë këtë shërbim. Ne jemi duke punuar intenzivisht në drejtim të përmirësimit të kësaj situatë, por inflacioni dhe rrethanat tjera na pamundësojnë të kemi kapacitetet e nevojshme. Shpresojmë që së shpejti të arrijmë të gjejmë një zgjidhje, por deri në një njoftim të dytë, kërkojmë mirëkuptimin tuaj.

Mirë mbetshi!



Donika Grezda

From: Office Syri Vision <office@syri-vision.tv>
Sent: Wednesday, October 30, 2024 10:57 AM
To: Donika Grezda
Cc: Artan Haraqia
Subject: Re: Njoftim per media

Caution! This message was sent from outside your organization.

[Allow sender](#) | [Block sender](#)

Përshëndetje

Ne paraprakisht diskutuaam përmes telefonit dhe u dakorduaam që përkohësisht të vazhdojmë me transmetim në web- faqe të komunës së Gjakovës, deri në momentin kur ne të rregullojmë çështjet teknike për të cilat jemi duke u përpjekur tash e sa kohë, dhe për të cilat ju kemi njoftuar paraprakisht, andaj ky email bie ndesh me njoftimet tona. Gjithashtu, të njoftuar për vështirësitë teknike që na pamundësojnë transmetimin e drejtpërdrejt në televizionin Syri keni qenë edhe përmes emailave paraprak, përmes telefonit sidhe gjatë takimit tonë.

Vlenë të ritheksohet se ne qëndrojmë prapa asaj që në vazhdimësi kemi kërkuar rritje të pagesës për shërbimet tona pasi na duhet të angazhojmë numër shumë të madh të stafit, sidhe pajisje të shumta teknike për të përcjellë mbledhjen e Kuvendit të komunës, sidhe për të përcjellë aktivitetet tjera që kërkojnë nga ana juaj.

Sic edhe jeni në dijeni, pagesa që I kryhet televizionit është e njëjtë me periudhën kur të punësuar kanë qenë rreth 5 persona, dhe tash kur janë mbi 30, rrjedhimisht nuk mbulohet as 10% e shpenzimeve, ndërsa shpenzohet mbi 20% e kohës sonë. Megjithatë, kërkesa jonë për rritje të pagesës është neglizhuar, sic edhe nuk hasëm në mirëkuptimin tuaj për problemet tona teknike, por në mënyrë ultimative kërkuat dicka që e kemi të pamundur ta realizojmë, duke njoftuar iniciimin e ndërprerjes së kontratës.

Gjithsesi, vendimi për shkëputje të bashkëpunimit tonë është në dorën tuaj, dhe neve nuk na mbetet gjë tjetër pos të pajtohemi me vendimin tuaj, dhe të ju urojmë më të mirat.

Sa I përket angazhimit tonë, ne zotohemi se pavarësisht se s' do të kemi kontratë për bashkëpunim, në momentin që i tejkalojmë vështirësitë teknike, do të vazhdojmë të përcjellim të gjitha aktivitetet e institucionit tuaj që ne e vlerësojmë që janë në interes të qytetarëve të komunës së Gjakovës. Televizioni Syri do të vazhdojë të jetë në shërbim të informimit objektiv, të papanshëm dhe gjithmonë transparent për të informuar të gjithë qytetarët tanë.

On Wed, 30 Oct 2024 at 09:46, Donika Grezda <donika.grezda@rks-gov.net> wrote:
Përshëndetje,

Shpresoj që ky email të ju gjejë mirë dhe punët po ju ecin mbarë.

Komuna e Gjakovës mbetet pranë kërkesës së njëjtë të paraqitur në email-in e kaluar e cila parasheh respektimin e plotë të kontratës mes nesh. Kjo nënkupton transmetimin e drejtëpërdrejtë dhe të plotë televiziv të mbledhjeve të Asamblesë Komunale, reprizën në orët e mbrëmjes dhe pikat tjera të specifikuara në kontratë. Pranimi i shërbimeve të përgjysmuara nënkupton shkelje të kontratës nga ana jonë. Ju njoftojmë se nëse kontrata nuk zbatohet si e plotë nga ana juaj, ne jemi të detyruar të iniciojmë procedurat për ndërprerjen e saj.

Me respekt,

Donika Grezda

Mënxhere e Kontratës

From: Office Syri Vision <office@syri-vision.tv>
Sent: Tuesday, October 29, 2024 15:59
To: Donika Grezda <donika.grezda@rks-gov.net>
Subject: Re: Njoftim per media

Përshëndetje

Ashtu siq edhe e kemi diskutuar paraprakisht, ne e kemi kuptuar rëndësinë e përcjelles së këtij aktiviteti, për faktin se I njëjti është I obliguar ligjërisht që të transmetohet në web-faqen e komunës së Gjakovës. Andaj, ekipi I televizionit Syri nesër do të jetë i pranishëm për të kryer xhirimet dhe transmetimin e materialit në fjalë në web faqen e komunës.

Siq edhe tashmë jeni të informuar, transmetimi I drejtëpërdrejt I mbledhjes së kuvendit të komunës në kanal in tonë televiziv është I pamundur për shkaqe teknike. Pavarësisht kësaj, do të mundohemi që brenda kapaciteteve tona të ju ofrojmë mbështetje në mënyrë që ju të jeni ligjërisht korrekt.

On Tue, 29 Oct 2024 at 14:27, Donika Grezda <donika.grezda@rks-gov.net> wrote:

Pershendetje,

Shpresoj qe ky email te ju gjeje mire dhe punët po ju ecin mbare.

Me poshtë gjeni njoftimin per mbledhjen e Asamblese Komunale.

Me respekt,